

R E Z O L U T Ë

12.5.1999

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë po ndjek me vëmendje dhe shqetësim të veçantë zhvillimin e ngjarjeve të kohëve të fundit në Kosovë. Regjimi i Milosheviçit po vazhdon me egërsinë më të madhe fushatën e spastrimit etnik të shoqëruar me masakra të papara ndaj popullsisë civile të pafajshme dhe të pambrojtur. Pothuajse e gjithë popullsia shqiptare e Kosovës është dëbuar nga vatrat e saj, duke u endur pyjeve, ndërsa një pjesë e konsiderueshme jashtë kufijve të Kosovës. Megjithë përpjekjet ushtarake dhe politike të bashkësisë ndërkombëtar zgjidhja e kësaj krize nuk duket të jetë e afërt.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, i angazhuar totalisht për të kontribuar në zgjidhjen e këtij problemi :

- dënon me ashpërsi dhunën, raprezaljet, masakrat dhe spastrimin etnik të popullsisë civile në Kosovë dhe kërkon intensifikimin e hetimeve nga Gjykata Ndërkombëtare e Hagës për krimet e luftës të kryera nga serbët në Kosovë;

- mbështet sulmet ajrore të NATO-s kundër makinës ushtarake dhe propagandistike të Milosheviçit, si dhe çdo zgjerim të operacioneve ushtarake, përfshirë ndërhyrjen nga toka;

- sheh si rrugë të sigurt për dhënien fund të konfliktit pranimin e pesë kushteve të vendosura nga NATO-ja e të shprehura edhe nga G - 8, duke përkrahur çdo opsion të bashkësisë ndërkombëtar që është në këtë linjë;

- shpreh nevojën e forcimit të unitetit të faktorit shqiptar e veçanërisht të atij në Kosovë, duke pasur si bazë Marrëveshjen e Rambujesë;

- njeh dhe përkrah Qeverinë e përkohshme me Kryeministër Thaçin, duke inkurajuar plotësimin e saj në bazë të marrëveshjes së arritur në Rambuje dhe bën thirrje për respektimin e saj nga të gjitha palët nënshkruese;

- njeh dhe përkrah Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, si një nga faktorët vendimtarë politikë dhe ushtarakë për zgjidhjen e krizës, si dhe rolin e tyre në lehtësimin e krizës humanitare e në mbrojtjen e popullsisë civile të Kosovës;

- mbështet dhënien Kosovës të statusit të protektoratit ndërkombëtar, vendosjen e forcave të NATO-s për të garantuar kthimin e të dëbuarve, stabilitetin e Kosovës e të gjithë rajonit, për krijimin e kushteve për ndërtimin e një shoqërie demokratike, të zgjedhjeve të lira dhe të së drejtës të popullit të Kosovës për të vendosur vetë për fatet e tij;

- përshëndet deklaratat e fundit të zotit Rugova që mbështesin bombardimet dhe vendosjen e forcave të NATO-s në Kosovë;

- njeh si të vetmin institucion për të negociuar për të ardhmen e Kosovës delegacionin shqiptar të Rambujesë, tashmë i gjithëpranuar prej popullit të Kosovës, duke mos u pajtuar me çdo tentativë për të përçarë faktorët kryesorë shqiptarë;

- përulet me nderim dhe respekt në kujtim të martirëve të kombit, luftëtarë të lirisë në Kosovë;

- shpreh keqardhjen e tij për të gjitha viktimat e popullsisë civile të Kosovës, dhe zemëratën më të thellë për vrasjen makabre të profesor Fehmi Aganit, një nga figurat më të shquara të jetës politike në Kosovë;

- shpreh mirënjohjen më të thellë për qeveritë e SHBA-së, atyre Europiane e të vendeve mike, NATO-n dhe organizmat e organizatat ndërkombëtare për kontributin, mbështetjen dhe angazhimin e tyre pa rezerva për dhënien fund të kësaj tragjedie të paparë në Europë këta 50 vjetët e fundit;

- mbështet plotësisht Qeverinë Shqiptare në qëndrimet e saj për problemin e Kosovës dhe në angazhimin e saj total dhe të strukturave të pushtetit vendor për pritjen e sistemitin e qindra - mijëra vëllezërve tanë kosovarë të ardhur në Shqipëri dhe i kërkon asaj të shtojë kontaktet dhe

praninë në mjediset politike vendimmarrëse;

- falënderon në mënyrë të veçantë gjithë popullin shqiptar për mikpritjen dhe bujarinë e jashtëzakonshme, rezervuar vëllezërve kosovarë;

- përshëndesim nismat për zhvillimin ekonomik dhe demokratik rajonal që çojnë drejt integritetit europian në mënyrë që Ballkani të shndërrohet në një rajon paqeje, stabiliteti dhe sigurie.

Tiranë, 12.5.1999